

**FOTOGRAFI
NGA JETA IME**

Çfarë mësova për paqen, ndërsa babai më mbante në shpinë



Gjatë gjithë jetës kam pasur vetëm një dëshirë në mendje. Doja të sillja paqe në botë, të ndërtoja një botë ku nuk ka luftëra dhe ku gjithë njerëzimi jeton në dashuri. Ndoshta dikush mund të thotë: “Si është e mundur që mendoje për paqen që kur ishe fëmijë?.” Kaq e habitshme qenka që një fëmijë të ëndërrojë për një botë në paqe?

Në vitin 1920, kur linda unë, Koreja ishte nën pushtimin e dhunshëm të Japonisë. Edhe pas çlirimit, në vitin 1945, erdhën me radhë Lufta Koreane, kriza financiare e Azisë dhe një numër krizash të tjera të vështira. Për shumë vite, toka e Koresë nuk ka pasur lidhje me paqen. Por këto kohë vuajtjesh dhe konfuzioni nuk ishin vetëm çështje të Koresë. Dy luftërat botërore, lufta e Vietnamit dhe luftërat në Lindjen e Mesme tregojnë që njerëzit vazhdimisht i drejtojnë armët dhe bombardojnë njëri-tjetrin. Ndoshta, për njerëzit që shohin këto tmerre, trupa të gjakosur e kocka të thyera, paqja ka qenë diçka që nuk e kanë parë as në ëndërr. Megjithatë, nuk është aq e vështirë për të arritur paqen. Pikësëpari, paqen e ndiejmë në ajrin që thithim, në natyrën që na rrethon dhe tek njerëzit që kemi afër.

Kur isha fëmijë, mendoja se lëndinat ishin shtëpia ime. Sapo mbaroja së ngrëni, si një ujë i uritur tasin e orizit për mëngjes, dilja me vrap nga shtëpia dhe e kaloja ditën nëpër kodra dhe në luginat e përrenjve. Isha në

gjendje të kaloja gjithë ditën duke u endur në pyje bashkë me zogjtë dhe kafshët e shumëllojshme, duke ngrënë bimë dhe manaferra të egra, dhe nuk ndjehesha kurrë i pangrënë. Edhe pse fëmijë, unë e dija se mendja dhe trupi çlodheshin sa herë shkoja në pyll.

Shpesh më zinte gjumi nëpër kodrat ku lozja. Babai detyrohej të dilte për të më kërkuar. Kur dëgjoja zërin e tij që më thërriste nga larg, “Jong Mjung! Jong Mjung!”, nuk rrija dot pa vënë buzën në gaz, edhe pse isha në gjumë. Më quanin Jong Mjung kur isha ende fëmijë. Zëri i tij më zgjonte nga gjumi, por unë vazhdoja të bëja sikur flija. Ai më hidhte në shpinë dhe më çonte në shtëpi. Ajo që unë ndjeja në ato çaste mbi shpinën e babait që zbriste me mua kodrën, një ndjenjë sigurie totale dhe lirie në zemër, ajo ishte paqja. Kështu mësova fillimisht se çfarë ishte paqja teksa pushoja mbi shpinën e tim ati.

Një arsye tjetër pse e doja pyllin ishte sepse e gjithë paqja e botës banon aty. Format e jetës në pyll nuk përleshën me njëra-tjetrën. Natyrisht, ato hanë një pjesë dhe hahen nga një pjesë tjetër, por këtë e bëjnë nga uria dhe nga nevoja për të mbijetuar. Ato nuk grinden nga armiqësia. Zogjtë nuk i urrejnë zogjtë e tjerë. Kafshët nuk i urrejnë kafshët e tjera. Pemët nuk i urrejnë pemët e tjera. Që të vijë paqja, duhet të shuhet armiqësia. Qeniet njerëzore janë të vetmit që urrejnë sojin e vet. Njerëzit urrejnë njerëzit e tjerë, sepse vijnë nga kombe të ndryshme, sepse kanë fe të ndryshme, apo sepse kanë mënyrë tjetër të menduari.

Kam qenë pothuajse në dyqind vende. Nuk kanë qenë të shumta vendet ku mund të zbrisja në aeroport dhe të thosha me vete: “Ky është me të vërtet një vend i paqshëm dhe i kënaqur”. Në shumë vende, për shkak të trazirave, ushtarët ishin në gatishmëri, ruanin aeroportet dhe postbllloqet e rrugëve. Të shtënat dëgjoheshin ditë e natë. Disa herë kam shpëtuar për fije pa u vrarë në vendet ku kam shkuar për të folur për paqen. Në botën e

sotme ka një numër të pafundmë konfliktesh dhe kundërvëniesh të mëdha dhe të vogla. Me dhjetëra miliona vuajnë nga uria, sepse nuk kanë asgjë për të ngrënë. Megjithatë, me miliarda e miliarda shpenzohen për armë. Vetëm paratë e shpenzuara për pushkë dhe bomba do të mjaftonin për t'i dhënë fund urisë për të gjithë.

Ja kam kushtuar jetën ndërtimit të urave të paqes midis vendeve që urrehen si armiq për shkak të ideologjisë dhe besimit. Kam krijuar forume ku kanë mundur të vijnë së bashku myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë. Kam punuar për të pajtuar pikëpamjet e Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Sovjetik, kur ishin në mosmarrëveshje në lidhje me Irakun. Kam ndihmuar për të sjellë pajtimin midis Koresë së Veriut dhe asaj të Jugut. Nuk i kam bërë këto gjëra për para apo për famë. Që kur arrita moshën për të kuptuar se çfarë po ndodhte në botë, kam pasur vetëm një objektiv në jetë: një botë që jeton në paqe si një e tërë. Asnjëherë nuk kam dashur gjë tjetër përveç kësaj. Nuk ka qenë e lehtë të jetosh natë e ditë me pikësynim paqen, por kjo është gjëja që më bën të lumtur më shumë sesa çdo gjë tjetër.

Gjatë Luftës së Ftohtë, ne përjetuam dhimbjen e ndarjes së botës tonë më dysh për shkak të ideologjisë. Në atë kohë dukej sikur mjaftonte të zhdukej komunizmi dhe paqja do të vinte menjëherë. Mirëpo, tani që Lufta e Ftohtë ka mbaruar, kemi akoma dhe më shumë konflikte. Tani jemi të përçarë nga racat dhe fetë. Shumë vende shohin matanë kufijve të tyre me dyshim dhe mosbesim. Sikur kjo të mos mjaftonte, kemi situata brenda një vendi ku njerëzit janë të ndarë për shkak të racës, besimit apo rajoneve ku kanë lindur. Njerëzit e quajnë armik njëri-tjetrin vetëm sepse ndodhen në anë të kundërta të këtyre vijave ndarëse, kështu që refuzojnë t'i hapin zemrën njëri-tjetrit.

Po t'i hedhim një sy historisë njerëzore, shohim se luftërat më të vra-

zhda dhe më mizore nuk kanë qenë ato midis kombeve, por ato midis racave. Ndër këto të fundit, më të këqijat kanë qenë ato ku feja është përdorur si pretekst. Në Luftën Civile të Bosnjës, një nga konfliktet më të përgjakshme të shekullit XX, u masakruan brutalisht me mijëra njerëz, mes të cilëve edhe shumë fëmijë. Në 11 shtator 2001, humbën mijëra jetë të pafajshme në ndërtesat e Qendrës Botërore të Tregtisë, në Nju York, kur ato u rrëzuan prej përplasjes me dy aeroplanë me pasagjerë. Gjithashtu, kohët e fundit, në Rripin e Gazës në Palestinë, në Izraelin jugor, me mijëra kanë humbur jetën për shkak të atij konflikti të thellë. Shtëpitë u janë shkatërruar dhe njerëzit janë në buzë të vdekjes. Të gjitha këto janë rezultate të zymta të konflikteve midis grupeve etnike dhe ndërmjet feve.

Çfarë i shtyn njerëzit të urrehen dhe të vriten kështu? Sigurisht, ka shumë arsye, por pothuajse të gjitha janë gjithmonë të lidhura me dallimet fetare. Kjo vlen edhe për Luftën e Gjirit. Është e njëjta gjë me konfliktin arabo-izraelit për kontrollin mbi Jerusalemin. Kur racizmi përdor fenë si pretekst, problemi merr një ndërlitim të skajshëm. Fantazmat zemërliga të luftërave fetare, për të cilat menduam se përfunduan me mesjetën, vazhdojnë të na shfaqen edhe në shekullin XXI.

Luftërat fetare vazhdojnë të përsëriten, sepse shumë politikanë përdorin armiqësinë midis feve për të përmbushur planet e veta egoiste. Përballë fuqisë politike, fetë shpesh lëkunden dhe humbasin rrugën. Ato harrojnë qëllimin fillestar, sipas të cilit, ato ekzistojnë për hir të paqes. Përgjegjësia e të gjitha feve është të çojnë përpara çështjen e paqes botërore, por, fatkeqësisht, në vend të kësaj, fetë janë ato që bëhen shkak i konfliktit. Në sfondin e kësaj fatkeqësie gjejmë intrigat e politikës me fuqinë dhe paratë e saj. Përgjegjësia e një udhëheqësi, mbi të gjitha, është të ruajë paqen. Megjithatë, shpesh, udhëheqësit bëjnë të kundërtën, dhe e çojnë botën drejt kundërvënies dhe dhunës.

Udhëheqësit përdorin gjuhën e fesë dhe të nacionalizmit për të fshehur ambiciet e tyre egoiste. Po të mos pastrojnë ata zemrat, popujt dhe kombet do të vazhdojnë të enden në konfuzion. As feja dhe as dashuria për kombin nuk janë të këqija në thelb. Ato marrin vlerë, kur përdoren për të kontribuar në ndërtimin e një komuniteti njerëzor global. Por, kur pretendohet se vetëm një fe apo një grup etnik i veçantë është i drejtë, dhe kur fetë e grupet e tjera etnike përçmohen dhe sulmohen, atëherë feja dhe dashuria për kombin e humbasin vlerën. Nëse një fe shkon deri aty sa të marrë nëpër këmbë të tjerët dhe t'i konsiderojë fetë e tjera kaq të pavlefshme, atëherë ajo nuk mishëron më mirësi. E njëjta gjë ndodh kur dashuria e një kombi përdoret nga dikush për të theksuar të drejtat e kombit të tij mbi kombet e tjera.

E vërteta e universit është se ne duhet ta pranojmë dhe ta ndihmojmë njëri-tjetrin. Edhe kafshët më të vogla e dinë këtë. Macja dhe qeni nuk shkojnë mirë, por nëse i rrit në të njëjtën shtëpi, ata i duan këlyshët e njëri-tjetrit dhe bëhen miq. E njëjta gjë shihet tek bimët. Hardhia që mbështillet rreth një peme, varet nga trunгу ku mbështetet. Sidoqoftë, pema nuk thotë: “Pse po mbështillesh rreth trupit tim?”. Parimi i universit është që të gjithë të jetojnë së bashku, për hir të njëri-tjetrit. Të gjithë ata që devijojnë nga ky parim, hasin shkatërrim të pashmangshëm. Nëse kombet dhe fetë do të vazhdojnë, djallëzisht, të sulmojnë të tjerët, njerëzimi nuk ka të ardhme. Do të jetë një cikël i pafundmë terrori dhe betejash, derisa një ditë do të zhdukemi. Por, ne nuk jemi pa shpresë. Me siguri që shpresë ka.

E kam jetuar jetën duke mos e lënë të më shuhet asnjëherë ajo shpresë, dhe gjithmonë e kam mbajtur gjallë ëndrrën e paqes. Unë dua të rrëzoj plotësisht muret dhe gardhet, që e ndajnë botën në mijëra mënyra, dhe të krijoj një botë në unitet. Dua të shemb muret që ndajnë fetë dhe racat

dhe të mbush hendekun midis të pasurve dhe të varfërve. Sapo të bëhet kjo, mund të rikrijojmë botën e paqes që Zoti krijoi në fillim. E kam fjalën për një botë ku askush nuk është i pangrënë dhe askush nuk derdh lot. Për të shëruar një botë, që s'ka shpresë dhe që i mungon dashuria, duhet të kthehemi tek ato zemra të pastra që kemi pasur kur kemi qenë fëmijë. Për t'u zhveshur nga dëshira për të pasur sa më shumë pasuri materiale dhe për të rigjetur bukurinë e thelbit tonë si qenie njerëzore, ne duhet të kthehemi tek parimet e paqes dhe fryma e dashurisë, që e kemi mësuar ndërsa baballarët na mbartnin mbi shpinë.

Gëzimi që ndien kur u jep ushqim të tjerëve



Unë kam sy shumë të vegjël. Më kanë thënë se, kur linda, nëna ime pyeste veten: “A ka sy ky fëmija im?” dhe m’i hapte qepallat me gishta. Dhe, kur kapsitja sytë, ajo thoshte me gëzim: “Oh, po! Shyqyr. I paska sytë!”, I kisha sytë aq të vegjël, sa shpesh më thërrisnin “syvogli i Osanit”, sepse nënën e kisha nga fshati Osan.

Megjithatë, nuk mbaj mend njeri të thoshte se sytë e vegjël më bënë më pak tërheqës. Në fakt, ata që kanë njohuri nga fizionomia, që është arti i njohjes së karakteristikave dhe i fatit të një personi duke studiuar karakteristikat e fytyrës, thonë se sytë e vegjël tregojnë, tek unë, prirjen për t’u bërë udhëheqës fetar. Mendoj se është njësoj si me kamerën, e cila ka mundësi të fokusojë një objekt që është larg, kur i zvogëlohet distanca midis thjerrave. Një udhëheqës fetar duhet të jetë i aftë të shohë në një të ardhme më të largët se ç’shohin njerëzit e zakonshëm dhe, ndoshta, sytë e vegjël janë tregues i një cilësie të tillë. Edhe hundën e kam të veçantë. Vetëm me një të parë duket se është hunda e një burri kokëfortë dhe të vendosur. Duhet të jetë diçka e lidhur me fizionominë, sepse, kur rishikoj jetën time, këto karakteristika të fytyrës duket sikur ngajnë me mënyrën si kam jetuar.

Kam lindur në Sang-sa Ri 2221 (fshat), në rrethin e Dok-on, qyteti

Xhong-xhu në Provincën e Pionganit, si djali i dytë i Kjung Ju Mun, i fisit Nam Pjung Mun dhe Jung Gie Kim, nga fisi Jong An Kim. Kam lindur në ditën e gjashtë të muajit të parë të kalendarit hënor më 1920, një vit pas lëvizjes për pavarësi të 1919-ës.

Më kanë thënë se familja jonë është vendosur në fshatin Sang-sa Ri që në kohën e stërgjyshit. Stërgjyshi nga ana e babait e punonte vetë tokën, prodhonte mijëra shinikë oriz duke e vënë pasurinë e familjes me duart e veta. Ai nuk pinte kurrë as duhan, as pije alkoolike. Parapëlqente më shumë t'i përdorte ato para për të blerë ushqim dhe për t'ua dhënë atyre që s'kishin. Kur vdiq, fjalët e tij të fundit ishin: "Nëse ushqen njerëz nga të gjitha viset e Koresë, atëherë do të marrësh bekime nga të gjitha ato vise". Prandaj dhoma e miqve në shtëpinë tonë ishte gjithmonë plot. Edhe banorë nga fshatra të tjerë e dinin që, po të vinin në shtëpinë tonë, e kishin të sigurt se do t'iu ofrohej një vakt i bollshëm. Nëna ime merrte përsipër të gatuar për gjithë ata njerëz pa u ankuar asnjëherë.

Stërgjyshi ishte shumë aktiv. Ai nuk donte të pushonte fare. Nëse kishte pak kohë të lirë, do të fillonte të bënte këpucë prej kashte për t'i shitur në pazar. Kur u plak, prej zemërgjerësisë së tij, bleu disa rosa dhe i la të lira; lutej që gjithçka t'u shkonte mbarë pasardhësve të tij. Ai pagoi një mësues të shkronjave kineze që të rrinte në dhomën e miqve dhe t'u mësonte shkrim e këndim falas të rinjve të fshatit.

Fshatarët i dhanë atij titullin e nderit "Sun Ok" (Xhevahiri i Mirësisë), ndërsa për shtëpinë tonë thoshin se "ajo shtëpi do të marrë bekime".

Pasi linda unë, dhe ndërsa rritesha, shumë nga pasuria që kishte vënë stërgjyshi kishte avulluar, dhe ne kishim sa për të jetuar. Megjithatë, tradita e familjes për të ndarë ushqimin me të tjerët ishte ende gjallë. U jepnim të tjerëve edhe sikur të mos kishim mjaftueshëm për vete. Gjëja e parë që mësova, pasi nisa të eci, ishte si t'u shërbeja ushqimin të tjerëve.

Gjatë pushtimit japonez, shumë prej koreanëve iu konfiskuan shtëpitë dhe tokat. Kur arratiseshin për në Mançuri, ku shpresonin të ndërtonin një jetë të re, kalonin para shtëpisë sonë, që ishte në rrugën kryesore për në Seong-cheong, në Provincën e Pyong-an verior. Nëna përgatiste gjithmonë ushqim për kalimtarët që vinin nga vise të ndryshme të Koresë. Nëse vinte një lypës të kërkonte ushqim dhe nëna nuk vepronte shpejt, gjyshi merrte ushqimin e vet dhe ia jepte. Ndoshta, ngaqë jam rritur në një familje të tillë, edhe unë kam shpenzuar shumë kohë nga jeta ime duke ushqyer të tjerët. Për mua, t'u japësh njerëzve për të ngrënë është puna më e çmuar. Kur jam duke ngrënë dhe shikoj dikë që nuk ka ç'të hajë, më dhemb në zemër dhe nuk mundem të vazhdoj të ha.

Do t'ju tregoj diçka që më ka ndodhur kur isha rreth njëmbëdhjetë vjeç. Ishte gati fund viti, dhe i gjithë fshati ishte duke përgatitur ëmbëlsira orizi për festën e Vitit të Ri. Por kishim disa fqinjë aq të varfër, sa nuk kishin asgjë për të ngrënë. Fytyrat e tyre më rrinin në mendje dhe kjo më bënte aq nervoz, saqë vërtitesha nëpër shtëpi dhe nuk dija çfarë të bëja. Më në fund, mora një thes tetë kilogramësh me oriz dhe dola me vrap nga shtëpia. Isha aq me ngut duke nxjerrë thesin e orizit, saqë nuk ia lidha mirë grykën. E ngrita thesin në shpinë dhe e mbaja fort ndërsa vrapoja nëpër rrëpirë, një rrugë e përpjetë rreth tetë kilometra, për të shkuar deri te shtëpia e fqinjëve. Isha shumë i gëzuar kur mendoja sa mirë do të ndiehesha kur t'u jepja atyre njerëzve ushqim të mjaftueshëm, që edhe ata të hanin sa të ngopeshin.

Mulliri i fshatit ishte afër shtëpisë sonë. Katër muret e mullirit ishin shumë të forta, në mënyrë që orizi i shtypur të mos dilte nga të çarat. Kjo do të thotë që ishte një vend i mirë për t'i shpëtuar erës së dimrit, dhe ku mund të rrije ngrohtë. Nëse dikush merrte shkarpa nga shtëpia jonë dhe ndizte një zjarr të vogël në mulli, bëhej më ngrohtë se në një dhomë e

ngrohur me ondol (sistemi i ngrohjes, në Kore, që e ngroh shtëpinë duke shpërndarë nxehtësinë nëpërmjet tubave nën dyscheme). Disa nga lypësit, që endeshin nëpër vend, vendosnin të kalonin dimrin në atë mulli. Unë hipnotizohesha nga historitë që tregonin për botën jashtë atyre mureve dhe e kaloja kohën me ta sa herë gjeja rast. Nëna ma sillte ushqimin tek mulliri dhe, gjithnjë, mendonte dhe për miqtë e mi lypës. Ne hanim në një pjatë dhe përdornim të njëjtat batanije për natën. Ja, kështu e kaloja dimrin. Kur vinte pranvera, ata largoheshin për në vendet e largëta. Mezi prisja të vinte dimri, që ata të ktheheshin sërish. Fakti që ishin të veshur keq nuk donte të thoshte aspak se edhe zemrat e tyre të ishin të rreckosura. Ata kishin një dashuri të ngrohtë dhe të thellë, që dukej. Unë u jepja ushqim dhe ata më jepnin dashuri. Shoqëria e ngushtë dhe ngrohtësia që më jepnin atëherë vazhdon të jetë një burim force për mua, edhe sot.

Ndërsa i bie botës rrotull dhe shoh vuajtjen e fëmijëve nga uria, më vjen gjithnjë në mendje gjyshi, i cili nuk rrinte kurrë pa e ndarë ushqimin e vet me të tjerët.

Të jesh shok me të gjithë



Nëse mendoj të bëj diçka, duhet ta vë atë në jetë menjëherë. Ndryshe, nuk me zë gjumi. Kur isha fëmijë, nganjëherë më vinte ndonjë ide gjatë natës, por isha i detyruar të prisja deri në mëngjes, para se ta vija në jetë. Rrija zgjuar dhe gërvishtja murin për të kaluar kohën. Kjo ndodhte aq shpesh, sa që gati kisha hapur një vrimë në mur dhe copat e dheut, që binin ishin bërë pirg mbi dysheme. Gjithashtu, nuk flija dot nëse gjatë ditës isha trajtuar padrejtësisht. Në këtë rast, ngrihesha nga shtrati gjatë natës, shkoja tek shtëpia e fajtorit dhe e thërrisja të dilte dhe të ndeshej me mua. Besoj se prindërit e mi e kanë pasur shumë të vështirë të më rrisnin.

Nuk duroja dot kur shikoja që dikush po trajtohej padrejtësisht. Sa herë kishte zënka midis fëmijëve të fshatit, do të përfshihesha sikur të isha përgjegjës për to, për të parë nëse drejtësia zbatohet në çdo rast. Unë e caktoja se cili nga fëmijët në zënkë ishte gabim dhe e qortoja me zë të lartë. Njëherë shkova të takoj gjyshin e një djali që ishte si kokorosh në lagje. I thashë atij: “Djali juaj ka bërë këtë e atë gabim. Të lutem, merru me të”.

Me veprime mund të isha shumë i egër, por, megjithatë, isha fëmijë me zemër të madhe. Nganjëherë shkoja për vizitë tek motra ime e madhe, që jetonte me familjen e burrit të saj, dhe kërkoja të më jepnin ëmbëlsirë orizi dhe pulë. Të rriturit nuk më merrnin kurrë inat për këtë gjë, sepse

e shikonin që zemra ime ishte e mbushur me dashuri të ngrohtë.

Kisha aftësi të veçanta për t'u kujdesur për kafshët. Kur zogjtë bënin fole në një pemë përballë shtëpisë sonë, gërmoja një vrimë të vogël për ta që të pinin ujë. Gjithashtu, merrja nga depoja mel të zhveshur, e shkoqja dhe e hidhja në tokë që ata ta hanin. Në fillim zogjtë fluturonin sa herë që u afrohej dikush. Por, shpejt e kuptonin se personi që u jepte ushqim i donte, prandaj, kur u afrohesha unë, ata nuk largoheshin më.

Njëherë mendova ta provoja të rrisja peshk. Kështu që kapa disa peshq dhe i futa në një gropë me ujë. Mora dhe një grusht ushqim dhe ua hodha në ujë. Por, kur u ngrita mëngjesin tjetër, pashë që të gjithë peshqit kishin ngordhur gjatë natës. Kisha kaq shumë qejf t'i mbaja ata peshq! Qëndroja atje i habitur, duke i vështruar se si pluskonin mbi ujë. Mbaj mend që qava gjithë ditën e ditës për këtë.

Im atë kishte shumë koshere me bletë. Ai merrte një koshere dhe e fiksonte mbi një bazament të thjeshtë poshtë saj. Atëherë bletët depozi-tonin atje dyllin për të krijuar hojet ku do të rezervonin mjaltin. Si fëmijë kureshtar, doja të shihja se si e ndërtonin bletët kosheren. Kështu që, një herë e ngjesha fytyrën në mes të kosheres dhe u ndëshkova rëndë prej bletëve, duke më shkaktuar ënjtje të tmerrshme të fytyrës.

Një herë tjetër ua hoqa bazamentin koshereve, dhe për këtë babai më qortoi keq. Sapo bletët mbaronin ndërtimin e hojeve, babai i merrte kosheret dhe i vinte mënjanë. Këto koshere ishin të mbuluara me dyllë bletësh, i cili mund të përdorej për ndriçim në vend të vajit. Unë i mora ato koshere të shtrenjta, i theva dhe ua çova familjeve që nuk kishin mundësi të blinin vaj për ndriçim. Ky ishte një veprim bamirësie, por që e bëra pa lejen e babait kështu, që, për atë, u qortova ashpër.

Kur isha dymbëdhjetë vjeç, nuk kishim shumë gjëra me se të luanim. Ato që kishim ishin një lojë si 'mos u nxeh' e quajtur 'loja jut', një lojë si

shahu, e quajtur 'xhang-gi' dhe loja me letra. Gjithmonë kënaqesha kur luanin shumë njerëz njëherësh. Gjatë ditës kisha qejf të luaja 'jut 'ose të ngrija balonën, dhe në mbrëmje organizoja raundet e lojërave me letra, që zhvilloheshin kudo në fshat. Ishin lojëra ku fituesi merrte 120 uon pas çdo dore, dhe unë, zakonisht, fitoja të paktën një herë në tri duar.

Pragu i Vitit të Ri dhe hëna e parë e plotë e çdo viti ishin ditët kur luheshin më shumë lojërat e kumarit. Gjatë atyre ditëve, policia bënte sikur nuk shikonte dhe nuk arrestonte askënd nga ata që luanin. Unë shkoja atje ku luanin kumar të rriturit, bëja një sy gjumë gjatë natës dhe i kërkoja të luanin me mua vetëm tri duart e fundit në mëngjes herët, sa për të bërë atë që e quanin kompensimi i natës. Me paratë që kisha fituar blija ushqime, lodra, karamelle dhe dhurata për shokët dhe për fëmijët e varfër nga fshatrat përreth. Nuk i përdorja paratë për vete, apo për të bërë diçka të keqe. Kur burrat e motrave të mia vinin për vizitë tek ne, u kërkoja leje dhe merrja para nga kuletat e tyre. Pastaj, me ato para, blija ëmbëlsira dhe shurup të ëmbël për fëmijët që nuk kishin.

Në një fshat është e natyrshme që ka njerëz që jetojnë mirë, dhe të tjerë që nuk jetojnë mirë. Kur shikoja që një fëmijë kishte marrë me vete, në shkollë, mel të zierë për drekë, nuk e haja dot drekën time me oriz, që ishte më e mirë. Kështu që, e ndërroja orizin tim me melin e tij. Ndihesha më i afërt me fëmijët e familjeve të varfra se me fëmijët e familjeve të pasura dhe doja që, në njëfarë mënyre, të isha i sigurt që nuk vuanin urie. Kjo ishte një lloj loje që më kënaqte më shumë se gjithë të tjerat. Isha ende fëmijë, por e ndieja që doja të isha shok me të gjithë. Në fakt, doja të isha më shumë se thjesht shok; doja të kisha marrëdhënie ku mund të shprehnim thellësinë e zemrës me njëri-tjetrin.

Një nga xhaxhallarët e mi ishte mjaft lakmitar. Familja e tij kishte një ngastër toke të mbjellë me pjepër, aty nga mesi i fshatit dhe, çdo verë,

kur pjeprat piqeshin dhe lëshonin një aromë ndjellëse, fëmijët e fshatit i luteshin atij që t'i lejonte të hanin disa. Mirëpo, im ungj ngrinte një tendë në rrugën pranë ngastrës dhe rrinte roje atje duke mos u dhënë as edhe një kokërr pjepër.

Një ditë shkova dhe e pyeta: “Xhaxha, a do të ishte problem sikur të shkoja një ditë te ngastra jote me pjepra dhe të haja sa të doja?”. Xhaxhai u përgjigj gjithë qejf: “Sigurisht, asnjë problem”.

Atëherë u çova fjalë gjithë fëmijëve se, kushdo që dëshironte të hante pjepër duhet të merrte me vete një çantë prej cohe të ashpër dhe të vinte para shtëpisë sime në mesnatë. Atë natë i udhëhoqa deri te ngastra e pjeprave të xhaxhait dhe u thashë: “Mblidhni nga një rresht pjepra secili dhe mos u shqetësoni për asgjë tjetër”. Fëmijët bërtitën nga gëzimi dhe vrapuan drejt ngastrës së pjeprave. Brenda vetëm disa minutave shumë prej rreshtave të pjeprave u pastruan. Atë natë, fëmijët e uritur të fshatit u ulën në një fushë tërfili dhe hëngrën pjepra sa iu dhembti barku.

Të nesërmen u bë një rrëmujë e madhe. Shkova në shtëpinë e xhaxhait dhe i gjeta në potere si një koshere bletësh e trazuar. “Ti kopuk,- më bërtiti xhaxhai.- Ti e bërë këtë? A je ti ai që hodhi poshtë punën time të një vitit të tërë për rritjen e pjeprave?”.

Çfarëdo të thoshte, nuk do të tërhiqesha. “Xhaxha,- i thashë,- nuk e mban mend? Ti, vetë më the që mund të haja pjepër sa të doja. Fëmijët e fshatit donin të hanin pjepra, dhe dëshira e tyre është edhe dëshira ime. A nuk ishte mirë t'u jepja atyre nga një pjepër secilit, apo duhet të mos u kisha dhënë asnjë kokërr?” Kur dëgjoji këtë, xhaxhai tha: “Ke të drejtë”. Ky ishte edhe fundi i inatit të tij.

Një busull e saktë për jetën time



Fisi Mun vjen nga Nampjungu, afër Provincës Naxhu, në provincën Çolla, një qytet rreth 320 km në jug të Seulit, në pjesën jugperëndimore të vendit. Babai i stërgjyshit tim, Sung Hak Mun, kishte tre djem. Më i vogli i tyre ishte stërgjyshi im, Xhung Hul Mun, i cili pati tre djem: Çi Guk, Shin Guk dhe Jun Guk. Gjyshi im, Çi Guk Mun qe më i madhi prej tyre.

Gjyshi Çi Guk Mun ishte analfabet, sepse nuk pati shkuar as në ndonjë shkollë fillore të kohës dhe as në ndonjë shkollë tradicionale të fshatit. Megjithatë, fuqia e tij e përqendrimit qe aq e madhe, saqë ishte në gjendje të recitonte tekstin e plotë të përkthimit në gjuhën koreane të Sam Kuk Zhi (një novelë e mirënjohur popullore e tre mbretërive në historinë klasike kineze), vetëm duke e dëgjuar kur ia lexonin të tjerët. Dhe jo vetëm historinë e Sam Kuk Zhi. Kur dëgjonte dikë që tregonte një histori interesante, ai mund ta memorizonte dhe ta tregonte fjalë për fjalë, ashtu siç e kishte dëgjuar. Ishte në gjendje të memorizonte çdo gjë, duke e dëgjuar vetëm një herë. Im atë i ngjante atij në këtë pikë; ishte në gjendje të këndonte përmendësh himnet krishtere, të cilat ishin më shumë se katërqind faqe.

Gjyshi i ndoqi fjalët e fundit të babait të vet, i cili ia la amanet që të jetonte me një shpirt bujar, por ai nuk qe në gjendje ta ruante pasurinë

e familjes. Kjo ndodhi sepse vëllai i tij më i vogël, xhaxhai i babait tim, Jun Guk Mun, mori para borxh duke lënë peng pasurinë e familjes, dhe, kështu, i humbi të gjitha. Pas këtij incidenti pjesëtarët e familjes kaluan disa vështirësi të mëdha, por gjyshi dhe babai nuk folën kurrë keq për xhaxhanë Jun Guk. Ata e dinin se ai nuk i kishte humbur paratë duke luajtur kumar ose duke bërë ndonjë gjë të atillë. Në fakt, ai ia dërgoi ato para qeverisë së përkohshme të Republikës së Koresë me bazë në Shangai, në Kinë. Në ato kohë, shtatëdhjetë mijë uon ishte një shumë e madhe. Këtë sasi parash i dhuroi lëvizjes për pavarësi xhaxhai i babait tim.

Xhaxhai i madh, Jun Guk, i diplomuar nga Seminari i Penianit dhe një ministër [i krishterë], ishte një intelektual që e zotëronte rrjedhshëm anglishten, dhe mjaft i zoti në studimet kineze. Ai ishte pastor dhe përgjigjej për tri kisha, ku përfshihej edhe kisha e Dok Hëngut në Dok Ion Mjon. Ai mori pjesë në hartimin e Deklaratës së Pavarësisë, më 1919, së bashku me Nam Son Ço.

Mirëpo, kur u zbulua se, midis nënshkruesve, tre prej gjashtëmbëdhjetë udhëheqësve të krishterë ishin të lidhur me kishën Dok Hëng, xhaxhait të babait tim iu hoq emri nga lista. Sëng Hëng Li, një nga nënshkruesit e mbetur, që kishte punuar me ungjin e tim eti për të hapur shkollën e Osanit, i kërkoi atij të kujdesej për të gjitha punët e tij, në rast se lëvizja e pavarësisë dështonte dhe nëse ai do të vdiste në duart e autoriteteve koloniale japoneze.

Drugës për t'u kthyer në vendlindje, ungji i madh Jun Guk shtypi dhjetëra mijëra flamuj koreanë dhe ua dha njerëzve që mbushën rrugët, duke mbështetur me thirrjet e tyre pavarësinë e Koresë. Ai u arrestua më 8 mars, ndërsa udhëhiqte një demonstratë në kodrën prapa zyrës administrative Aipo Mjong. Në këtë demonstratë në mbështetje të pavarësisë morën pjesë drejtori, trupi pedagogjik dhe rreth dy mijë studentë të

shkollës së Osanit, afro tre mijë të krishterë dhe rreth katër mijë banorë të tjerë të zonës. Vëllai i gjyshit tim, Jun Guk Mun, u dënua me dy vjet burg dhe vuajti dënimin në burgun e Juxhusë. Vitin tjetër ai u lirua pas një faljeje speciale.

Edhe pasi e liruan, për shkak të përndjekjes nga policia japoneze, ai nuk mund të rrinte gjatë në një vend, ndaj ishte gjithmonë në lëvizje, nga një vend në tjetrin. Në trup kishte një shenjë të madhe qëkur e kishin torturuar policët japonezë duke e shpuar me thupra bambuje, derisa pak nga pak ia hiqnin edhe mishin. Qe shpuar në këmbë dhe në anë të brinjëve, por thoshte se kurrë nuk ishte dorëzuar. Kur japonezët e panë që nuk e mposhtnin dot, i ofruan postin e kryetarit të qarkut, nëse premtonte se nuk do të merrej më me lëvizjen për pavarësi. Përgjigjja e tij ndaj japonezëve ishte qortuese dhe me zë të lartë: “Si mund të mendoni se do të pranoja ndonjë post dhe do të punoja për ju, o hajdutë?”.

Kur isha shtatë-tetë vjeç, xhaxhai Jun Guk qëndroi në shtëpinë tonë për një kohë të shkurtër, dhe disa nga radhët e ushtrisë koreane për pavarësi vinin e takoheshin me të. Atyre po u mbaronin fondet dhe kishin udhëtuar natën, në këmbë, në mes të një dëbore të dendur, për të arritur në shtëpinë tonë. Babai na mbuloi ne, fëmijëve, kokat me jorgan që të mos zgjoheshim. Unë, në fakt, isha krejt zgjuar dhe rrija aty nën jorgan, me sytë filxhan, dhe dëgjoja sa të mundja zërat dhe bisedën e të rriturve. Megjithëse ishte vonë, nëna theri një zog dhe zjeu ca makarona për t’ua shërbyer luftëtarëve për pavarësi.

Edhe sot i mbaj mend fjalët që u tha xhaxhai i babait, ndërsa isha i shtrirë atje nën jorgan, duke mbajtur frymën i emocionuar. “Edhe po të vdisni,- tha ai,- nëse vdisni për kombin, atëherë do të bekoheni”. Dhe vazhdoi: “Tani mundet që shohim vetëm errësi para nesh, por drita e mëngjesit patjetër që do të shfaqet”. Për shkak të torturave, ai nuk e përdorte dot gjithë trupin, por zëri i tij kumbonte me forcë.

Gjithashtu, mbaj mend që thosha me vete: “Pse një njeri kaq fisnik si vëllai i gjyshit tim duhej të shkonte në burg? Po qe se do të ishim më të fortë se Japonia, atëherë kjo gjë nuk do të kishte ndodhur”.

Xhaxhai i madh Jun Guk vazhdoi të endej nëpër Kore, duke iu shman-gur përndjekjes japoneze, dhe ne nuk dinim asgjë për të deri më 1966, kur unë isha në Seul dhe mora lajme prej tij. Ai i ishte shfaqur në ëndërr njërit prej kushërinjve të mi më të vegjël dhe i kishte thënë: “Jam varrosur në Xhong Son, në provincën Kanguon”. Shkuam në adresën që na kishte treguar në ëndërr dhe zbuluam se ai kish vdekur nëntë vite më parë. Mbi varrin e tij gjetëm vetëm një pirg dheu me barëra të këqija. Unë ia mora eshtrat dhe i rivarrosa në Paxhu, në provincën Kiongi, në afërsi të Seulit.

Pas çlirimit të Koresë nga Japonia, më 1945, komunistët në Korenë e Veriut vranë pa dallim misionarët e krishterë dhe luftëtarët për pavarësi. Xhaxhai i madh, duke pasur frikë se prania e tij do të cenonte familjen, u arratis nga komunistët, kapërceu paralelin 38 për në jug dhe u vendos në Xhongson. Askush nga familja jonë nuk kishte dijeni për këtë. Në atë luginë të thellë malore ai jetonte duke shitur penela kaligrafie. Më vonë, na thanë se kishte hapur një shkollë tradicionale fshati, ku jepte mësim mbi klasikët kinezë. Sipas disa prej ish-studentëve të tij, shpesh i pëlqente të krijonte, spontanisht, poema në gjuhën kineze. Studentët e tij zbardhën dhe ruajtën rreth 130 poema, duke përfshirë edhe këtë të mëposhtmen:

PAQJA VERI-JUG

*Vite kanë kaluar qëkur ika nga Veriu për në Jug
Rrjedha e kohës shpejton zbardhjen e flokëve të mi
Dua të kthehem në shtëpi, por si?
Mendova se do të rrija për pak, por zgjati,*

*Me veshjen krahëgjatë prej kërpi të verës
bëj fresk me erashkën e mëndafshhtë
dhe rri e mendoj se ç'mund të na sjellë vjeshta
Paqja midis Jugut dhe Veriut është pranë
Fëmijët presin nën strehët e çatave
Mos u shqetësoni shumë*

Megjithëse i ndarë nga familja dhe duke jetuar në Xhong son, një tokë fare e panjohur për të, zemra e ungjit të madh Jun Guk ishte e mbushur me ankth për vendin e tij. Ai la pas edhe këtë varg poetik:

*“Kur vendos një qëllim,
që në fillim betohu për një standard të lartë;
mos lejo të kesh
as edhe një grimcë dëshirash private”*

Kontributi që i dha xhaxhai i babait tim lëvizjes për pavarësi u njoh, pas vdekjes, nga qeveria e Republikës së Koresë, më 1977, me një Çmim Presidencial dhe, më 1990, me Urdhrin e Meritës për Themelimin e Kombit. Edhe tani, ka raste që recitoj vargjet e tij poetike. Ato janë të mbushura me dashuri të patundur për atdheun, madje, edhe në mes të fatkeqësive të skajshme.

Kohët e fundit, sa më shumë plakem, aq më shpesh mendoj për xhaxhanë Jun Guk. Çdo frazë e poezive të tij, që shpreh zemrën e tij të shqetësuar për atdheun më prek thellë në zemër. U kam mësuar anëtarëve tanë këngën Dehan Xhiri Ga (Këngën e gjeografisë koreane), fjalët e së cilës janë shkruar nga dora dhe pena e Jun Guk. Kënaqem kur e këndoj këtë këngë me anëtarët. Kur e këndoj atë, nga mali Bekdu deri në malin Hala, ndihem i çliruar nga hallet e mia.

KËNGË PËR GJEOGRAFINË E KORESË

*Gadishulli i Koresë, në Lindje
Në mes të tri kombeve.
Në veri, fushat e gjera të Mançurisë
Në lindje, Deti i thellë, blu i Lindjes,
Në jug, një det me shumë ishuj,
Në perëndim, i thelli Det i Verdhë.
Thesari ynë me gjithëfarëlloj peshqish
Ushqimi në detet e të tria anëve.
Në veri qëndron Mali i madh Bekdu,
që mbush me ujë lumenjtë Amrok dhe Tuman.
Që derdhen në detet e perëndimit e lindjes.
Është ai që shënon kufirin me sovjetikët
Mali Kumgang shkëlqen fuqishëm në qendër,
Një rezervat për botën, krenari e Koresë.
Mali Halla ngrihet mbi Detin blu të Jugut
Si një piketë për peshkatarët në det
Katër fushat e Dedongut, Hangangut, Gumgangut dhe Xhonxhusë
I japin popullit ushqim e veshje.
Katër minierat e Unsanit, Sunanas, Geçonit dhe Xheriungut
Na japin thesaret e Tokës.
Katër qytetet e Kiungsungut, Penianit, Degusë dhe Kesungut
ndriçojnë gjithë vendin.
Katër portet e Busanit, Uonsanit, Mokpos dhe Inçeonit
Mirëpresin anijet e huaja.
Nga Kjunsung shpërndahen hekurudhat,
Që lidhin dy linjat kryesore, Kjung-Hui dhe Kjung-Bu,*

*Degëzimet Kjong-Uon dhe Honam shkojnë në veri dhe jug,
Duke mbuluar tërë gadishullin.*

*Qytetet na tregojnë historinë tonë:
Pioniangu, qyteti dymijë vjeçar i Dangunit,
Kesung, kryeqyteti i Korios,
Kjungsung, kryeqyteti 500-vjeçar i Çosunit,
Kjongxhu, 2000 vite të kulturës Shila
ndriçojnë origjinën e Pak Hjukosai,
Çungçongu ka Bujon, kryeqytetin historik të Pekçeve.*

*Djemtë e Koresë që çajnë drejt së ardhmes,
Valët e qytetërimit po prekin brigjet tona.
Dilni nga kodrat
dhe marshoni përpara me furi
drejt botës të së ardhmes!*

Një fëmijë kokëfortë, që nuk heq dorë nga e vetja



Babai nuk ishte i mirë për të mbledhur borxhet e dhëna, por kur merrte, do të respektonte premtimin që kishte dhënë për shlyerjen e tij, edhe nëse do t'i duhej të shiste lopën, apo edhe sikur t'i duhej të hiqte një nga kolonat e shtëpisë dhe ta shiste në pazar. Ai thoshte gjithmonë: “Nuk e mbulon dot të vërtetën me dredhi. Çdo gjë e vërtetë, nuk është e mundur të sundohet nga një dinakëri e vogël. Gjithçka që vjen nga dredhia nuk do të shtyjë më shumë se disa vite, përpara se të zbulohet”.

Babai ishte trupmadh. Ishte aq i fortë, sa nuk kishte asnjë vështirësi të ngjiste shumë shkallë duke mbajtur një thes me oriz në kurriz. Fakti që, në moshën nëntëdhjetëvjeçare, akoma jam në gjendje të udhëtoj rreth botës dhe të vazhdoj punën time, vjen si rezultat i fuqisë fizike që kam trashëguar nga im atë.

Nëna, së cilës i pëlqente shumë himni i krishterë “Vendi më i lartë”, ishte gjithashtu një grua mjaft e fortë. Unë i ngjaj asaj, jo vetëm nga balli i madh dhe nga fytyra e rrumbullakët, por edhe nga karakteri i drejtpërdrejtë dhe shpirti i lartë. Kam një dell kokëforti, prandaj nuk ka dyshim që jam biri i nënës sime. Kur isha fëmijë, më njihnin si “qaramani 24 orësh”. Ma kishin ngjitur këtë nofkë, sepse, po të filloja të qaja, nuk pushoja gjithë ditën. Kur qaja, bërtisja aq shumë, sa njerëzit mendonin se kishte ndodhur

diçka e tmerrshme. Ata ngriheshin nga gjumi e dilnin për të parë çfarë po ndodhte. Veç kësaj unë nuk qaja i ulur në një vend. Hidhesha përpjetë nëpër dhomë, duke bërë potere dhe, me raste, gjakosësia e lëndohesha. Kisha një karakter kaq të gjallë, qëkur isha fëmijë.

Kur e ndaja mendjen, nuk bëhej fjalë që të tërhiqesha, edhe sikur të më thyhej ndonjë kockë e trupit. Natyrisht, gjithë këto kanë ndodhur para se unë të arrija pjekurinë. Rastiste që nëna më qortonte për diçka që e kisha bërë gabim, por unë i kthehesha duke i thënë: “Jo, absolutisht jo!”. Gjithë ç’duhet të bëja ishte ta pranoja se e kisha gabim, por parapëlqejta të vdisja sesa të lejoja ato fjalë të më dilnin nga goja. Megjithatë, edhe nëna ime kishte një personalitet mjaft të fortë.

Ajo më qëllonte dhe më thoshte: “A mendon se mund t’ia dalësh duke mos iu bindur prindërve?”. Njëherë më qëlloi aq fort, sa më rrëzoi përtokë. Edhe pasi u ngrita unë nuk u nënshtrova. S’dinte ç’të bënte, dhe, veç, qëndroi, para meje duke qarë me të madhe. Edhe në këtë situatë, unë prapë nuk e pranoja që isha gabim. Shpirti im konkurrues që po aq i fortë, sa edhe kokëfortësia ime. Nuk e pranoja dot humbjen në asnjë lloj situatë. Të rriturit e fshatit thoshin: “Syvogli i Osanit, po vendosi diçka, do ta bëjë medoemos”.

Nuk e mbaj mend sa vjeç kam qenë kur ka ndodhur kjo. Një djalë më goditi sa më doli gjak nga hundët dhe ia mbathi vrapit. Që nga ajo ditë, për një muaj rresht, shkoja tek shtëpia e tij çdo ditë dhe qëndroja atje duke e pritur të dilte. Të rriturit u çuditën kur panë që këmbëngula, derisa prindërit e tij më kërkuan falje. Madje, më dhanë edhe një kuti plot me ëmbëlsira orizi. Kjo nuk do të thotë që jam përpjekur gjithnjë të fitoj me kokëfortësi. Fizikisht isha shumë më i madh dhe shumë më i fortë se fëmijët e moshës sime. Asnjë nuk më mposhte në mundje krahu. Njëherë humba, në mundje krahu, me një djalë, që ishte tre vjet më i madh se unë,

dhe u bëra aq nervoz, sa nuk rrija dot në një vend. Shkova në një mal aty afër, hoqa lëvoret e një peme akacieje dhe u stërvita për gjashtë muaj te kjo pemë, çdo mbrëmje, për t'u bërë aq i fortë, sa ta mundja atë djalin. Pas gjashtë muajsh, i kërkova të ndesheshim sërish dhe arrita ta mposht.

Çdo brez i familjes sonë ka pasur shumë fëmijë. Unë kisha një vëlla më të madh, tri motra më të mëdha dhe tri motra më të vogla. Në fakt, kisha patur edhe katër vëllezër dhe motra të tjera, që kishin lindur pas Hjo Sonit, motrës më të vogël, por ata kishin vdekur ende foshnja. Nëna lindi trembëdhjetë fëmijë, por pesë nga ata nuk mbijetuan. Zemra saj duhet të ketë qenë shumë e lënduar. Nëna ka vuajtur shumë për të rritur kaq shumë fëmijë, në rrethana që nuk ishin aspak të bollëkshme. Isha fëmijë me shumë vëllezër e motra. Nëse mblidheshim të gjithë, së bashku me kushërinjtë e parë dhe të dytë, ishim në gjendje të bënim gjithçka. Sidoqoftë, ka kaluar aq shumë kohë, sa më duket sikur jam i vetmi që kam mbetur në këtë botë.

Njëherë bëra një vizitë të shkurtër në Korenë e Veriut, në vitin 1991. Shkova në vendlindje, për herë të parë, pas 48 vjetësh, dhe mora vesh që nëna dhe shumë nga vëllezërit dhe motrat e mia kishin vdekur. Kishin mbetur vetëm një motër e madhe dhe një motër e vogël. Motra e madhe, që kishte qenë si nënë për mua kur isha fëmijë, ishte bërë një gjyshe shtatëdhjetë e ca vjeçare. Motra e vogël ishte nën gjashtëdhjetë vjeç, por fytyrën e kishte plot rrudha.

Kur ishim të vegjë unë e ngacmoja shumë. I thërrisja: “Ej, Hjo Son! Ti do të marrësh një burrë me një sy”. Ajo më kthehej duke më thënë: “Çfarë the? Nga e di ti këtë gjë, vëlla?” Pastaj vraponte të më kapte dhe më godiste në shpinë me ato grushtet e saj të imëta.

Kur u bë tetëmbëdhjetë vjeç Hjo Son takoi një burrë, me të cilin donte ta martonte një nga hallat tona. Atë mëngjes ajo u ngrit herët, krehu flokët

me kujdes dhe vuri pudër në fytyrë. Pastroi me themel gjithë shtëpinë brenda e jashtë dhe priste të vinte dhëndri i mundshëm. “Hyo Seon,- e ngacmoja ,- ti duhet të kesh shumë dëshirë të martohesh”. Kjo e bënte atë flakë të kuqe dhe ende e mbaj mend sa e bukur dukej me atë fytyrë, që skuqej nën pudrën e bardhë.

Janë bërë thujasë njëzet vite qëkur kam vizituar Korenë e Veriut. Motra e madhe, e cila qante dhimbshëm kur më takoi, ka ndërruar jetë, duke e lënë vetëm motrën e vogël. Kjo gjë më mbush me kaq shumë ankth. Më duket sikur zemra do të më shkrihet dhe do të më venitet.

Duart i përdorja shumë mirë, aq sa bëja edhe rroba për vete. Kur ftohej koha, shpejt e shpejt, thurja një kapuç për vete. E bëja këtë më mirë se gratë, prandaj i tregoja dhe motrës së madhe ndonjë sekret të thurjes. Njëherë bëra me shtiza një shall për Hjo Sonë. I kisha duart aq të mëdha dhe aq të trasha, si putra ariu, por prapë më argëtonte puna me gjilpërë; me të unë mund të bëja edhe rrobat e mia të brendshme. Merrja një copë, e palosja më dysh, e prisja sipas skicës së duhur, i ktheja anët, e qepja dhe e vishja. Kur bëra njëherë një palë çorape tradicionale koreane, ime më e shprehu kënaqësinë duke thënë: “Pa shiko, pa shiko. Unë kujtoja se djali im i vogël e kalonte kohën kot, por këto që ka bërë më rrikan tamam”.

Në ato kohëra duhej të endje rroba pambuku, si pjesë e përgatitjes për dasmën e vajzës ose të djalit. Nëna merrte pambuk të papërpunuar dhe e vinte në një rrotë tjerrëse për ta bërë fije. Kjo quhej togengi (tjerrje) në dialektin e provincës Piong-an. Ajo vinte njëzet fije dhe bënte rroba pambuku me dymbëdhjetë fije, trembëdhjetë fije e kështu me radhë. Sa herë që martohej një fëmijë, nëna, me duart e saj të ashpra, përgatiste rroba pambuku sa të buta, aq edhe të bukura, si prej sateni të përpunuar. I kishte duart jashtëzakonisht të shpejta. Të tjerat mund të endnin tri ose katër pjesë të një pëlhure togengi në ditë, ndërsa nëna ime mund të

endte deri në njëzet. Kur nxitonte të përfundonte përgatitjet e dasmës së ndonjërës prej motrave të mia të mëdha, ishte në gjendje të endte një rul të tërë pëlhure në ditë. Nëna ishte e paduruar. Sa herë vendoste të bënte diçka, do të punonte me shpejtësi derisa ta mbaronte. Në këtë pikë unë i ngjaj asaj.

Që fëmijë, gjithmonë më pëlqente të haja shumë lloje ushqimesh. Kënaqesha duke ngrënë misra, kastravecë, patate dhe fasule të pagatuara. Duke shkuar për tek kushërinjtë e mi nga ana e nënës, që jetonin rreth tetë kilometra larg shtëpisë sonë, vura re një gjë të rrumbullakët që rritej në fushë. Pyeta çfarë ishte dhe më thanë se ishte xhi-gua, ose “patate e ëmbël”. Dikush gërmoi, nxori një, e zjeu në avull për mua, dhe unë e hëngra. Kishte një shije kaq të mirë, sa që mora një shportë plot dhe e hëngra të gjithën vetë. Për një vit pas kësaj, nuk rrija dot më shumë se tri ditë pa vajtur tek fshati i atyre kushërinjve. Thërrisja “nënë, po dal pak” dhe e bëja me vrap gjithë rrugën, deri tek vendi ku jetonin ata, dhe haja patate të ëmbla.


Atje ku jetonim ne, në maj, ndodhte ajo që quhej “shtegu i patates” ose mungesa e patateve. E nxirrnim dimrin me patate derisa vinte pranvera, dhe pastaj fillonim të korrnim elbin. Maji ishte periudha më kritike sepse, nëse rezerva e patateve ishte boshatisur para se të korrej elbi, njerëzit fillonin të vdisnin urie. Të mbijetoje në kohën kur rezervat e patateve ishin në fund dhe kur elbi nuk ishte korrur akoma, ishte njëlloj sikur të ngjiteshe në shtegun e një maloreje të thepisur. Prandaj e quanim shtegu i patates.

Elbi që hanim atëherë nuk ishte ky elb i shijshëm dhe i lëmuar që shohim sot. Kokrrat ishin të forta dhe me formë më cilindrike, por, megjithatë ne nuk e kishim problem. E vinim elbin në ujë për dy ditë, para se ta gatuanim. Kur uleshim për të ngrënë, unë e shtypja atë me lugë që të ngjiteshin kokrrat me njëra-tjetrën. Por nuk ishte gjë që bëhej.

Kur e ngrija me lugë, përsëri ai përhapej sikur të ishte rërë. E përzieja me goçuxhang (salcë speci e kuqe) dhe mbushja gojën. Kur e përtypja, kokrrat e elbit më dilnin përmes dhëmbëve, kështu që më duhej ta mbaja gojën të mbyllur fort.

Gjithashtu, shpesh kapnim dhe hanim edhe bretkosa pemësh. Në atë kohë, në zonat e thella, fëmijëve u jepnin bretkosa pemësh kur i kapte fruthi dhe kur fytyrat u holloheshin nga rënia në peshë. Ne kapnim tri ose katër nga këto bretkosa, që ishin të mëdha dhe kishin mjaft mish në këmbët e tyre të dhjamosura. I piqnim të mbështjella me gjethe kungulli dhe bëheshin shumë të buta dhe të shijshme, sikur të ishin zier me avull në një zierëse orizi. Meqë po flas për gjëra të shijshme, nuk mund të lë pa treguar për mishin e harabelave dhe fazanëve. Ne i gatuanim vezët e bukura shumëgjyreshe të zogjve të malit dhe tufat e shpendëve të ujit fluturonin mbi fusha, duke lëshuar tinguj të lartë dhe gulçues. Ndërsa endesha nëpër kodra e fusha, kuptova që një bollëk i madh ushqimor ekzistonte në mjedisin natyror, të cilin vetë Zoti na e kishte dhuruar.

Të duash natyrën që të mësosh prej saj



Personaliteti im ishte i tillë që doja të dija gjithçka për gjërat që më zinte syri. Nuk mund ta kaloja diçka në mënyrë sipërfaqësore. Filloja të mendoja: “Si do ta ketë emrin ai mali atje? Çfarë do të ketë atje lart?”. Më duhej të shkoja dhe ta shihja vetë. Ndërsa isha akoma fëmijë, i kam ngjitur deri në majë të gjitha malet që ishin në një rreze prej tetë kilometrash nga shtëpia jonë. Shkoja kudo, madje edhe matanë maleve. Prandaj, kur shikoja një mal që ndriste nën rrezet e mëngjesit, e imagjinoja çfarë kishte atje, dhe vetëm kështu, arrija ta vështroja me kënaqësi. Vendet që nuk i njihja nuk doja as t’i hidhja sytë. Unë duhej të kisha dijeni mbi gjithçka që mund të shihja, madje, edhe çfarë kishte matanë tyre. Ndryshe bëhesha aq nervoz, sa nuk duroja dot.

Kur shkoja nëpër male, prekja të gjitha lulet dhe pemët. Nuk isha i kënaqur vetëm duke i parë gjërat me sy; më duhej t’i prekja lulet, t’u merrja erë, madje, t’i fusja dhe në gojë e t’i përtypja. Më kënaqnin kaq shumë aromat, prekja dhe shijet, sa nuk doja t’ia dija edhe sikur dikush të më thoshte ta fusja kokën atje dhe ta mbaja tërë ditën. E doja aq shumë natyrën, saqë, kurdoherë që shkoja atje, kaloja gjithë ditën duke bredhur nëpër kodra e fusha, dhe harroja që duhet të kthehesha në shtëpi. Kur motrat e mëdha shkonin në kodra për të mbledhur perime të egra, u

tregoja rrugën deri lart në kodër dhe mblihdja bimët. Falë kësaj përvoje, unë di shumë për shumë lloje perimesh të egra me shije të mirë dhe vlera të mëdha ushqimore. Është e rëndësishme të kapësh ritmin e saktë, për të shijuar aromën e mrekullueshme të sëmbagui (bimë e egër që i pëlqen koreanëve për rrënjët dhe gjethet e saj). Kur e përzieje me brumë fasuleje të kuqe dhe e vendosje në një pjatë me bibimpab e koçuxhan, kishte një aromë të mrekullueshme. Kur ha sëmbagui, duhet ta fusësh në gojë dhe duhet ta mbash frymën për disa sekonda. Kjo është koha, gjatë së cilës, shija e hidhur largohet për t'i lënë vendin një shijeje tjetër.

Më pëlqente edhe të ngjitesha nëpër pemë. Kryesisht hipja dhe zbrisja nëpër një pemë gështenje dyqindvjeçare që e kishim në oborr. Më pëlqente pamja kur isha në degët e sipërme të asaj peme. Shikimi shkonte madje përtej hyrjes së fshatit. Kur ngjitesha atje, nuk doja të zbrisja më. Nganjëherë rrija lart në pemë deri natën vonë, derisa më e vogla nga motrat dilte nga shtëpia e nervozuar dhe përpiquej të më mbushte mendjen të zbrisja, sepse ishte e rrezikshme.

“Jong Mjung, të lutem zbrit - thoshte ajo.- Është vonë dhe duhet të hysh brenda e të flesh gjumë”.

“Nëse më flihet, mund të fle këtu.”

Nuk kishte rëndësi se çfarë thoshte ajo; unë nuk lëvizja nga dega e pemës së gështenjës. Më në fund, asaj i soste durimi dhe më bërtiste: “Hej, majmun! Zbrit poshtë! Tani”.

Ndoshta, ngaqë kisha lindur në vitin e majmunit, mua më pëlqente aq shumë të ngjitesha nëpër pemë. Kur kurorat e gështenjave vareshin në grumbuj, nga degët, merrja një degë të thyer dhe kërceja lart e poshtë për t'i rrëzuar. E mbaj mend që kisha shumë qejf ta bëja këtë. Më vjen keq për fëmijët e sotëm, që nuk rriten në fshat dhe nuk përjetojnë këtë lloj argëtimi.

Edhe zogjtë që fluturonin në qiell ishin objekt i kureshtjes time. Nganjëherë në të rrallë, afroheshin disa zogj me pamje të veçantë, dhe unë studioja gjithçka që mundja rreth tyre, duke vënë re me kujdes se ç'pamje kishte mashkulli dhe ç'pamje kishte femra. Në atë kohë nuk kishte libra që të më tregonin rreth llojeve të ndryshme të pemëve, shkurreve dhe zogjve, prandaj më duhej t'i vëzhgoja vetë secilën. Shpesh mbetesh pa ngrënë, sepse iu ngjitesha maleve, duke kërkuar vendet se ku shkonin zogjtë shtegtarë.

Njëherë, e ngjita dhe e zbrita një pemë, çdo mëngjes dhe mbrëmje, për disa ditë rresht, për të kontrolluar një fole laraskash. Doja të shihja se si i ngrohte vezët një laraskë. Më në fund e pashë sesi i ngrohu vezët laraska dhe u bëra miku i saj. Por, herët e para, laraska nxirrte një klithmë të fortë dhe trazohej shumë, sapo i afrohesha unë. Sidoqoftë, më vonë, edhe kur i afrohesha, ajo rrinte e qetë.

Edhe insektet e asaj zone ishin miqtë e mi. Çdo vit, në fund të verës, një gjinkallë me zë të pastër këndonte në degët e sipërme të një peme hurme, ngjitur me dhomën time. Unë ndiehesha i çliruar kur zhurma e lartë dhe irrituese e gjinkallave të tipit tjetër, që bënin zhurmë gjithë verës, papritur do të pushonte dhe do të zëvendësohej me këngën e gjinkallës me zë të pastër. Kënga e saj më njoftonte, se lagështia e verës së shpejti do të kalonte për tu zëvendësuar nga freskia e vjeshtës.

Tingulli i tyre ishte si diçka e tillë: “Sulu sulululululu!” Sa herë dëgjoja gjinkallën me zë të pastër që këndonte në këtë mënyrë, shikoja lart në pemën e hurmës dhe mendoja: “Sigurisht, përderisa do të këndoje, duhet të rrijë në një vend të lartë, në mënyrë që gjithkush në fshat të mund ta dëgjojë dhe të kënaqet. Kush do ta dëgjonte, nëse do të hynte në një gropë të thellë dhe do të këndonte atje?”

Shpejt e kuptova që edhe gjinkallat e verës, edhe gjinkallat me zë të

pastër, lëshonin tinguj dashurie. Sido që këndonin, “mem, mem, mem” apo “sulu sulu,” në të dyja rastet ato lëshonin tinguj për të tërhequr partnerët e tyre. Kur e kuptova këtë nuk e mbaja dot të qeshurën, sa herë dëgjoja një insekt që fillonte të këndonte. “Oh, ti do dashuri, apo jo? Vazhdo e këndo dhe gjej për vete një partner të mirë”. Gradualisht mësova si të jem shok me gjithçka në natyrë, aq sa isha në gjendje të shprehja edhe zemrën me ta.

Bregu i Detit të Verdhë ishte vetëm katër kilometra larg shtëpisë sonë. Ishte aq afër, sa mund ta shihja nga çdo vend i lartë afër shtëpisë. Kishte një sërë pellgjesh me ujë, rrugës për në det, dhe një përrua rridhte ndërmjet tyre. Shpesh gërmoja në ndonjërin prej atyre pellgjeve, që kundërmonin ujë të ndenjtur, për të kapur ngjala, ose gaforre të ujërave të ëmbla. Trazoja në çdo lloj vendi për të kapur gjallesa të ndryshme uji, kështu që arrita të kuptoj se ku jeton njëra dhe ku jeton tjetra. Ngjalave, nga natyra, nuk u pëlqen të duken, prandaj e fshihin trupin e stërzgatur nëpër vrimat e gaforreve apo në vende të tjera të ngjashme. Por, shpesh nuk e fusin dot të gjithë trupin nëpër vrima, kështu që fundi i bishtit të tyre mbetet jashtë. I kapja shumë kollaj nga bishti dhe i tërhiqja për t’i nxjerrë nga vrima. Nëse kishim miq në shtëpi, dhe ata donin të hanin ngjala të bëra në avull, për mua nuk ishte asgjë të vrapoja gjashtë kilometra, vajtje-ardhje, për tek pellgjet e ujit dhe të sillja rreth pesë ngjala. Gjatë pushimeve të verës, shpesh, kapja mbi dyzet ngjala në ditë.

Por kisha edhe një detyrë, që nuk më pëlqente ta bëja. Të kullojsja lopën. Shpesh, kur babai më thoshte të kullojsja lopën, e çoja në lëndinën e fshatit fqinj, ku, pasi e lidhja, ikja. Por, pas pak, filloja të shqetësohesha për lopën. Kur shikoja prapa, e vija re që ishte akoma, atje ku e kisha lidhur. Thjesht rrinte aty, gjysmë dite, duke pëllitur dhe duke pritur që dikush të vinte e t’i jepte për të ngrënë. Tek dëgjoja lopën që pëlliste nga

larg, mua më vinte keq dhe mendoja: “Ah, kjo lopë! Si t’ia bëj me të?”. Ndoshta mund ta imagjinoni si ndihesha që nuk po i merrja parasysh pëllitjet e lopës. Megjithatë, kur kthehesha tek ajo në mbrëmje, nuk ishte e inatosur dhe as nuk më qëllonte me brirë. Përkundrazi, dukej e lumtur që më shikonte. Kjo më bëri të kuptoj se, perspektiva e një personi për një objektiv më të lartë në jetë, duhet të jetë njëlloj si ajo e një lope: prit me durim se diçka e mirë do të vijë.

Kishim një qen në shtëpi, të cilin e doja shumë. Ishte aq i zgjuar, sa kur vinte koha të kthehesha nga shkolla, vinte me vrap të më takonte, kur isha ende mjaft larg. Sa herë më shihte, lumturohej. E fërkoja gjithmonë me dorën e djathtë. Kështu që, nëse ndodhej rastësisht nga ana ime e majtë, do të vërtitej për të shkuar nga ana e djathtë dhe fërkonte turinjtë tek unë duke m’u lutur ta përkëdhelja. Atëherë, unë ngrija dorën e djathtë dhe e fërkoja në kokë dhe në shpinë. Nëse nuk e fërkoja, atëherë qeni angullinte dhe rrotullohej rreth meje teksa vazhdoja rrugën. “Ah ti zagar, - i thosha, - ti e kupton dashurinë, apo jo? A të pëlqen dashuria?”

Kafshët e kuptojnë dashurinë. A keni parë ndonjëherë një kllloçkë të ulur mbi vezët e saj derisa të çelin? Ajo i mban sytë katër dhe i ngul këmbët në tokë që asnjë të mos i afrohet. Hyja dhe dilja në kafazin e zogjve, duke ditur që kllloçka inatosej. Kur hyja në kafaz, pula tendoste qafën dhe mundohej të më kërcënonte. Në vend që të tërhiqesha, edhe unë veproja në mënyrë kërcënuese ndaj pulës. Pasi hyja disa herë, pula bënte sikur nuk më shihte. Por rrinte në gatishmëri, me thonjtë e mprehtë të zgjatur. Dukej sikur donte të më hidhej e të më sulmonte, por nuk lëvizte dot se kishte vezët. Prandaj rrinte aty në ankth. I afrohesha dhe i prekja pendët, por ajo nuk lëvizte. Dukej sikur ishte e vendosur të mos lëvizte nga ai vend, derisa të çelnin vezët, edhe sikur t’ia shkulinin të gjitha pendët nga gjoksi. Për arsye se ka një dashuri dhe një lidhje të pazgjidhshme me

vezët, pula ka një autoritet që, madje, nuk lejon as këndesin të bëjë çfarë të dëshirojë. Ajo ka autoritet të plotë mbi gjithçka nën qiell, sikur thotë: “Nuk dua t’ia di kush je. Do të ishte mirë të mos i ngacmoje këto vezë!”

Ka një shprehje dashurie edhe kur dosa pjell gicat e saj. Ndoqa një dosë, derisa arrita ta shikoja teksa pillte të vegjlit e saj. Në çastin e lindjes, nëna dosë i jep një të shtyrë, të shoqëruar me një hungërimë të lartë, dhe gici rrëshqet në tokë. Dosa lëshon një hungërimë tjetër dhe nxjerr një të dytë. Është e njëjta gjë me macet dhe qentë. Lumturohesha shumë kur shikoja si vinin në këtë botë këta këlyshë të vegjël, që nuk kishin hapur akoma sytë. Nuk e mbaja dot të qeshurën dhe gëzimin.

Nga ana tjetër, më shkaktonte shumë ankth të shikoja një kafshë kur ishte duke ngordhur. Pak më larg fshatit ishte një thertore. Sapo lopa futej brenda në thertore, një kasap dilte papritmas dhe e godiste me një çekiç të hekurt, pothuajse sa parakrahu i një njeriu. Lopa shembej për tokë. Pas kësaj, i rripej lëkura dhe i priteshin këmbët. Jeta mbahej aq dëshpërimisht, sa cungjet e mbetura nga këmbët e prera të lopës vazhdonin të dridheshin. Lotët më rridhnin lumë kur shikoja këtë skenë dhe qaja me të madhe.

Që kur isha fëmijë, kam pasur një tipar të çuditshëm: dija gjëra që të tjerët nuk i dinin, sikur të kisha aftësi paranormale të natyrshme. Nëse thosha që do të bjerë shi, binte shi. Mund të isha i ulur në shtëpi dhe thosha: “Plaku, apo filani në fshatin tjetër nuk është mirë sot”. Dhe gjithmonë kisha të drejtë. Që kur isha tetë vjeç, isha i mirënjohur si kampioni i mblesëve. Mjaftonte të shihja fotografitë e nuses e dhëndrit të ardhshëm dhe isha në gjendje të thosha gjithçka. Nëse thosha: “Kjo martesë është e keqe”, dhe nuk e merrnin parasysh por martoheshin, ndarja e tyre më vonë ishte e pashmangshme. E kam bërë këtë gjë derisa sa kam shkuar 90 vjeç, dhe tani jam në gjendje të them shumë gjëra në lidhje me një person, thjesht duke parë mënyrën sesi ulet, ose si qesh.

Nëse i përqendroja mendimet, isha në gjendje të tregoja se çfarë ishin duke bërë motrat e mia në një çast të caktuar. Kështu, megjithëse motrat e mëdha më donin shumë, më kishin edhe shumë frikë. E ndienin që i dija të gjitha sekretet e tyre. Mund të duket sikur kam një fuqi të jashtëzakonshme paranormale, por, në fakt, nuk ka asgjë për t'u çuditur. Madje, edhe mizat e dheut, të cilat i mendojmë si qenie të parëndësishme, janë në gjendje të tregojnë se kur është duke ardhur sezoni i reshjeve, dhe futen atje ku nuk i zë shiu. Njerëzit, në akord me natyrën duhet të jenë në gjendje të tregojnë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen e tyre. Kjo nuk është edhe aq e vështirë.

Ju mund ta dini se në çdrejtim do të fryjë era duke vështuar me kujdes një fole laraskash. Laraska e vendos hyrjen e folesë në drejtim të kundërt me atë që do të fryjë era. Merr me sqepin e saj fije bari të thara dhe i thur së bashku, në një mënyrë të ndërlikuar, pastaj merr baltë me sqep dhe e suvaton folenë, nga jashtë dhe nga brenda, që të mos hyjë shiu. I rregullon fijet e kashtës në mënyrë të tillë, që të gjitha të shohin në të njëjtin drejtim. Ashtu si ulluku i një çatie, kjo bën që shiu të rrjedhë në një vend të caktuar. Kur, edhe laraskat kanë një zgjuarsi të tillë, që i ndihmon të mbijetojnë, atëherë a nuk do të ishte e natyrshme që edhe njerëzit të kishin aftësi të tilla?

Nëse do të isha në pazarin e kafshëve me babanë, mund të thosha: “Baba, mos e bli këtë lopë. Një lopë e mirë duhet të duket që nga zverku i qafës dhe duhet të ketë shputa të forta të këmbëve të para. Duhet të ketë mollaqe dhe shpinë të fortë. Kjo lopë nuk është e tillë”. Siç mund të pritej, ajo lopë nuk shitej. Babai më thoshte: “Nga i di ti të gjitha këto?”. I përgjigjesha: “I kam ditur që kur isha në barkun e nënës”. Sigurisht, nuk e kisha seriozisht.

Nëse i do lopët, mund të tregosh shumë gjëra për to. Forca më e madhe

në botë është dashuria, dhe gjëja më e frikshme është një mendje e një trup i bashkuar. Nëse qëndroni të heshtur dhe e përqendroni mendjen, ekziston një vend shumë i thellë, ku mendja është në gjendje të pushojë. Duhet ta lejoni mendjen të shkojë në atë vend. Kur e vendosni mendjen në atë vend dhe shkoni të flini, atëherë, kur të zgjoheni, do të jeni jashtëzakonisht i ndjeshëm. Ai është çasti kur duhet të përzini çdo mendim pa lidhje dhe ta përqendroni ndërgjegjen tuaj. Atëherë do të jeni në gjendje të komunikoni me gjithçka. Nëse nuk më besoni, provojeni që tani. Çdo formë jete në tokë përpiqet të lidhet me atë që i jep dashurinë më të madhe. Prandaj, nëse keni diçka që nuk e doni vërtet, atëherë zotërimi apo dominimi juaj është i rremë, kështu që do të detyroheni të hiqni dorë prej tij.

Të flasësh rreth universit me insektet



Ta kalosh kohën në pyll të pastron mendjen. Fëshfëritja e gjetheve që lëkunden nga era, zhurma e erës që fryn midis kallamave, zëri i kuakjeve të bretkosave në pellgje - gjithçka që mund të dëgjosh janë tinguj të natyrës; asnjë mendim pa lidhje nuk të hyn në mendje. Nëse e boshatisni mendjen dhe mirëprisni natyrën në tërësinë e qenies suaj, nuk ka ndarje ndërmjet jush dhe natyrës. Ajo hyn brenda jush dhe ju bëheni një me të. Në çastin kur kufiri midis jush dhe natyrës zhduket, ju provoni një ndjenjë të thellë gëzimi. Atëherë natyra bëhet ju dhe ju bëheni natyrë. I kam ruajtur gjithmonë si thesar përvoja të tilla të jetës sime. Madje, edhe tani, mbyll sytë dhe hyj në gjendjen ku jam një me natyrën. Disa e quajnë këtë anatman ose “mungesë e vetvetes”, por për mua është më shumë se kaq, sepse natyra hyn dhe pushon në atë vend që është bosh. Ndërsa jam në atë gjendje, dëgjoj tingujt që m'i dërgon natyra, tingujt e pemëve të pishave, të insekteve, dhe kështu, ne bëhemi shokë. Mund të shkoja në një fshat dhe, pa takuar asnjëri atje, e dija prirjen e mendjes së njerëzve që jetonin aty. Shkoja në fushat e fshatit, kaloja natën atje dhe dëgjoja çfarë më thoshin të korrat. Isha në gjendje të dalloja nëse të korrat ishin të mërzitura apo të lumtura, dhe nga kjo kuptoja se ç'lloj njerëzish jetonin atje. Arsyeya pse nuk ndihesha i vetmuar apo i izoluar kur isha në burg në Korenë e Jugut, në Shtetet e Bashkuara, madje, edhe në

Korenë e Veriut, ishte se qeshë në gjendje të dëgjoja tingujt e erës që frynte dhe të flisja me insektet që ishin atje me mua.

Ju mund të pyesni: “Çfarë bisedon me insektet?” Edhe kokrriza më e vogël e rërës përmban parimet e botës; madje, edhe një pikël pluhuri, që pluskon në ajër, përmban harmoninë e universit. Gjithçka rreth nesh ka lindur në sajë të një kombinimi forcash kaq të komplikuar, saqë ne as mund t’i imagjinojmë. Këto forca janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Asgjë në univers nuk është ngjizur jashtë zemrës së Zotit. Thjesht lëvizja e një gjetheje ka brenda frymëmarrjen e universit.

Që në fëmijëri, ndërsa endesha kodrave dhe lëndinave, kam pasur dhuntinë të rezonoja me tingujt e natyrës. Natyra krijon një harmoni të vetme dhe prodhon një tingull, që është i mrekullueshëm dhe i bukur. Asgjë nuk përpiqet të dalë mbi të tjerët dhe asgjë nuk injorohet; ekziston një harmoni supreme. Sa herë kam hasur vështirësi, natyra më ka ngushëlluar; sa herë kam rënë në dëshpërim, më ka ngritur nga e para. Fëmijët në ditët e sotme rriten në zona urbane dhe nuk kanë mundësi të familjarizohen me natyrën, por zhvillimi i ndjeshmërisë ndaj natyrës është, në fakt, më i rëndësishëm se zhvillimi i njohurive tona. Çfarë vlere ka t’i sigurosh arsim të lartë një fëmije, që nuk është në gjendje të ndiejë natyrën në gjirin e vet dhe ndjeshmëria e të cilit është e plogët? Njeriu i ndarë nga natyra mund të mbledhë dije nga librat sa këtu-atje dhe, pastaj, shumë lehtë bëhet një njeri individualist që adhuron të mirat materiale.

Ne kemi nevojë të ndiejmë dallimin midis tingujve të shiut në verë, që bie si një pëshpërimë e lehtë, dhe shiut të vjeshtës, që bie me kërcitje. Vetëm ai që gëzon rezonancën me natyrën mund të thuhet se ka një karakter të vërtetë. Një lule radhiqe, që ka mbirë dhe lulëzon në anë të rrugës, është më e çmuar se gjithë ari i botës. Na duhet të kemi një zemër që di si ta dojë natyrën dhe si t’i dojë njerëzit. Ai që nuk është në gjendje të dojë natyrën dhe njerëzit, nuk është në gjendje të dojë Zotin. Gjithçka në krijim mishëron Zotin në nivelin e

simbolit, dhe qeniet njerëzore janë qenie substanciale të krijuara si shëmbëlltë e Zotit. Vetëm një person që do natyrën është në gjendje të dojë Zotin.

Unë nuk e shpenzoja gjithë kohën vetëm duke bredhur e duke luajtur nëpër kodra e lëndina. Edhe punoja shumë, duke ndihmuar vëllanë e madh në punët e bujqësisë. Në bujqësi ka shumë punë që duhen bërë gjatë një stine. Orizoret dhe fushat e tjera duhen pluguar. Fidanët e orizit duhen mbjellë dhe barërat e këqija duhen hequr. Kur pastron barërat, detyra më e vështirë është të shkulësh barërat e këqija të një fushe me elb. Pasi mbillen farat, brazdat duhet të tëharren të paktën tri herë, dhe kjo është një punë gjatë së cilës të bie kurrizi. Kur mbaronim, për një copë herë nuk e drejtonim dot kurrizin. Patatet e ëmbla nuk bëhen shumë të shijshme, nëse mbillen në tokë argjilore. Ato duhet të mbillen në një përzierje një e treta argjilë, me dy të tretat tokë ranore, që të japin kokrra të ëmbla me shijen më të mirë të mundshme. Për misrin, jashtëqitja e njeriut ishte plehu më i mirë, kështu që merrja dhe i copëtoja me dorë të gjitha pjesët e forta të jashtëqitjes. Duke ndihmuar në punët e bujqësisë mësova se ç'nevojitej për t'u rritur mirë fasulet, ç'loj toke ishte e mirë për sojën dhe ç'tokë ishte e mirë për fasulet e kuqe. Jam një bujk bujku.

Provinca e Pjonganit ishte ndër të parat në Kore që kishte përqafuar kulturën e krishterë. Një ndikim i dukshëm i kësaj ishte se toka bujqësore në vitet 1930 dhe 1940 rregullohej me vija të drejta. Për të mbjellë fidanët e orizit, ne merrnim një shkop me 12 ndarje të barabarta, që tregonin vendin ku do të ishin rreshtat dhe e shtrinin për së gjati në orizore. Pastaj, dy njerëz vazhdonin të lëviznin, duke mbjellë gjashtë rreshta me fidanë secili. Më vonë, kur erdha në pjesën jugore të Koresë, pashë që vendosnin një fije përmes orizores dhe punonin 12 veta që përplaseshin me njëri-tjetrin. Dukej që ishte një mënyrë joefikase. Unë i hapja këmbët sa dyfishi i gjerësisë së shpatullave, në mënyrë që t'i mbilla fidanët më shpejt. Gjatë sezonit të mbjelljes së orizit, isha në gjendje të fitoja aq para, sa të paguaja shkollimin për vete.

Student entuziast



Kur u bëra dhjetë vjeç, babai më dërgoi në shkollën tradicionale të fshatit, ku një i moshuar na mësonte klasikët kinezë. Në këtë shkollë, gjithë çka duhet të bënim ishte të mësonim përmendsh një broshurë çdo ditë. Unë përqendroheshja dhe e bëja këtë brenda një gjysmë ore. Nëse viheshja para mësuesit dhe recitoja mësimin e ditës, atëherë kisha mbaruar për atë ditë. Nëse në fillim të pasdites mësuesi dremiste, ikja dhe shkoja nga kodrat dhe lëndinat. Sa më shumë kohë shpenzoja në kodra, aq më shumë mësoja ku të gjeja bimët e ngrënshme. Rrjedhimisht, haja aq shumë nga ato bimë, saqë nuk haja më drekë në shtëpi.

Në shkollë lexonim “Analeket”, mësimet e Konfucit dhe veprat e Mencius-it, si dhe mësonim shkronjat kineze. Unë dalloheshja për shkrimin dhe, kur u bëra dymbëdhjetë vjeç, mësuesi më thoshte të bëja shkronjat model, nga të cilat mund të mësonin nxënësit e tjerë. Në fakt, dëshiroja të ndiqja një shkollë zyrtare dhe jo një shkollë tradicionale fshati. E ndjeva që nuk duhet thjesht të mësoja përmendësh Konfucin dhe Mencius-in, ndërkohë që të tjerët po ndërtonin aeroplanë. Ishte prill dhe babai e kishte bërë pagesën vjetore të shkollimit tim. Megjithëse e dija këtë, vendosa të lija shkollën e fshatit dhe u përpoqa ta bind babanë të më dërgonte në një shkollë zyrtare. U përpoqa të bindja gjyshin, madje, edhe xhaxh-

hanë tim. Për t'u transferuar në një shkollë fillore, më duhej të jepja një provim. Që të studioja për këtë provim, më duhej të ndiqja një shkollë përgatitore. Ia mbusha mendjen njërit prej kushërinjve të mi më të vegjël të vinte me mua, kështu që, të dy hymë në Uonbong, një shkollë private që do të na ndihmonte të përgatiteshim për provimin e transferimit në shkollën fillore.

Vitin tjetër, kur isha katërmbëdhjetë vjeç, e mora provimin dhe u transferova në klasën e tretë të shkollës së Osan-it. Fillova me vonesë, por studiova shumë dhe arrita të hidhem në klasën e pestë. Shkolla e Osan-it ishte tetë kilometra nga shtëpia jonë, por unë asnjëherë nuk shkoja me vonesë dhe nuk mungova as edhe një ditë. Sa herë ngjisja kodrën gjatë rrugës, kishte një grup nxënësish që më prisnin. Megjithatë, ecja aq shpejt, sa e kishin të vështirë të ruanin ritmin njëlloj me mua. Kështu, pra, udhëtoja në atë rrugë mali, ku thuhej se, nganjëherë, shfaqeshin tigra.

Shkolla e Osan-it qe një shkollë nacionaliste, e themeluar nga Ji Sung Hun, që ishte aktiv në lëvizjen për pavarësi. Jo vetëm që nuk mësohej gjuha japoneze, por nxënësit ndaloheshin edhe të flisnin japonisht. Unë kisha mendim tjetër për këtë çështje. E ndjeja që duhet ta njihnim armikun për ta mundur atë. Bëra një provim tjetër transferimi dhe hyra në vitin e katërt të Shkollës Normale Publike në Xhong Xhu. Në shkollat publike, të gjitha mësimet jepeshin në japonisht, kështu që mësova përmendësh *katakanan* dhe *hiraganan*, një natë para ditës së parë në atë shkollë. (*Katakana dhe hiragana janë dy lloje të ndryshme shkrimesh që përdoren për të shkruar gjuhën japoneze*). Unë nuk dija asnjë fjalë japonisht, kështu që mora të gjitha tekstet, që nga klasa e parë, deri në të katërtën, dhe i mësova përmendësh brenda dy javëve. Kjo më mundësoi të filloja të kuptoja gjuhën.

Kur mbarova gramatikën, e dija japonishten rrjedhshëm. Ditën e diplomimit, dola vullnetar për të mbajtur një fjalim para gjithë njerëzve

të rëndësishëm të Xhong Xhu-së, që ishin mbledhur aty. Normalisht, në atë situatë, nxënësi pritet të flasë me mirënjohje për mbështetjen që ka marrë nga mësuesit dhe shkolla. Në vend të kësaj, unë iu drejtova të gjithë mësuesve të mi me emra dhe i kritikova, duke nxjerrë në pah problemet në mënyrën se si po drejtohej shkolla. Gjithashtu, fola për rëndësinë e kohës tonë në histori dhe për vendosmërinë që duhet të kenë njerëzit me përgjegjësi. E mbajta këtë fjalim, mjaft kritik, të gjithin në japonisht.

“Japonezët duhet të bëjnë gati valixhet dhe duhet të nisen për në Japoni sa më shpejt që të jetë e mundur”, -iu thashë. “Kjo tokë na është lënë trashëgim nga paraardhësit tanë, kështu që gjithë brezat e ardhshëm të popullit tonë duhet të jetojnë këtu”.

I thashë këto gjëra përpara shefit të policisë, përgjegjësit të qarkut dhe kryetarit të baskisë së qytetit. Po ndiqja shembullin e xhaxhait të babait, Jun Guk Mun dhe po thosha gjëra që askush nuk guxonte t’i thoshte. Audienca u trondit. Kur u largova nga skena, pashë se fytyrat e njerëzve ishin zverdhur. Mua nuk më ndodhi asgjë atë ditë, por problemet erdhën më vonë. Që nga ajo ditë, policia japoneze më piketoi si një person në gjurmim dhe filloi të më ndjekë, duke u bërë e bezdisshme. Më vonë, kur po përpiqesha të shkoja në Japoni për të vazhduar studimet, shefi i policisë refuzoi të vinte vulën në një formular që më duhej, gjë që më solli telashe. Ai më konsideronte si një person të rrezikshëm që nuk duhet të lejohet të udhëtojë në Japoni dhe refuzoi të vulosë. Bëra një diskutim të ashpër me të dhe, më në fund, e binda të ma vuloshte formularin. Vetëm atëherë munda të shkoj në Japoni.